

Fakte mbi Aktivitetin Filantropik
2016
Shqipëria

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
Tiranë, Shqipëri 2017

Autore:
Maris Selamaj

Prej vitit 2011 Partnerët Shqipëri punon për promovimin e filantropisë në vend . Duke marrë në konsideratë informacionet e pakta në këtë fushë, Partnerët Shqipëri kreu studimet:

- “Sipërmarrja dhe Filantropia” për të krijuar një kuptim më të qartë të shkallës dhe natyrës së kauzave shoqërore të cilat mbështeten prej komunitetit të biznesit në Shqipëri,
- “Një Vështrim Historik mbi Zhvillimin e Filantropisë në Shqipëri”, që trajton këtë veprimtari, figurat kryesore dhe aktivitetin e tyre filantropik brenda dhe jashtë vendit, nga shekulli i XIX e deri në ditët e sotme,
- “Aktiviteti Filantropik i Ndërmarrjeve në Shqipëri, Studimi i Dytë, 2016” i cili synon të vlerësojë nivelin dhe karakteristikat e aktivitetit filantropik që kryen sektori i biznesit në Shqipëri, tiparet e zhvillimit të këtij aktiviteti gjatë periudhës 2011-2016, si dhe tendencat për të ardhmen.

Për të promovuar dhe mbështetur zhvillimin e kësaj traditë të hershme dhe me vlera, Partnerët Shqipëri organizon tashmë prej gjashtë vitesh ceremoninë “Çmimi i Filantropisë”, duke shprehur mirënjohjen dhe falenderimin për individët, familjet dhe bizneset që kontribuojnë për përmirësimin e cilësisë së jetës në vend. Vlerësimi dhe stimulimi i një aktiviteti të tillë mbetet i rëndësishëm për dimensionin human dhe ekonomik që ai mbart.

Sektori i biznesit luan, midis aktorëve të tjerë, një rol të rëndësishëm në mbështetjen e iniciativave që adresojnë probleme të mprehta sociale, ekonomike dhe mjedisore. Në këtë funksion, Partnerët Shqipëri ka vendosur një partneritet të ngushtë me sektorin e biznesit në mbështetje të bizneseve të reja sociale në fushën e industrisë së gjelbërt. Prej vitit 2013 Partnerët Shqipëri organizon konkursin vjetor “Ide të Gjelbërta” si pjesë e të cilit mbështeten sipërmarrje që promovojnë përfshirjen sociale, integrimin dhe punësimin, nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve lokale e ringjalljes së traditave, duke ndjekur një përjasje miqësore ndaj mjedisit. Risia qëndron në bashkëpunimin dhe krijimin e një fondi investimi të përbashkët të krijuar nga dhurime të bizneseve dhe institucioneve filantropike private, lokale dhe ndërkombëtare në mbështetje të bizneseve të reja të gjelbërta. Automatikisht, idetë fituese konkurrojnë në nivel Ballkanik në konkursin “Filantropia për Ide të Gjelbërta” organizuar nga Rockefeller Brothers Fund.

Metodologjia

Ky raport pasqyron aktivitetin filantropik në Shqipëri gjatë vitit 2016 i sjellë në mënyrë të sintetizuar nga Partnerët Shqipëri, bazuar në monitorimin ditor dhe **raportimin e rregullt mujor**.

Metodologjia e përdorur për realizimin e tij u bazua në të dhëna të mbledhura nga hulumtimi ditor i mediave, përfshi ato sociale si dhe nga institucionet publike dhe jo-publike gjatë periudhës janar - dhjetor 2016.

Mbledhja e të dhënave është mbështetur nga **Catalyst Balkans**, një iniciativë që i ka fillesat e saj në fillim të vitit 2013, për të nisur matjen dhe krijimin e mjeteve për promovimin e rritjes dhe përmirësimit të transparencës së filantropisë individuale dhe të biznesit në Ballkanin Perëndimor. Objektivat specifike të organizatës janë grumbullimi dhe shpërndarja e informacionit, lajmeve dhe të dhënave rreth filantropisë në rajon nëpërmjet databazës GivingBalkans. Zyra qendrore e Catalyst është në Beograd dhe mbulon përveç Serbisë edhe Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Kroacinë, Kosovën dhe Maqedoninë. Monitorimi ditor është kryer nëpërmjet plaformës **klipingmap.com**, një motor kërkimi bazuar në fjalë kyçe.

Raporti analizon sektorët dhe çështjet kryesore që janë mbështetur, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve dhe përfituesve.

Nëpërmjet këtij monitorimi, Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe të informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij.

Fjalor


OJF - Organizata Jofitimprurëse.

Publik i Gjerë - Grupe njerëzish apo individë, të cilët janë ndihmuar nëpërmjet ndihmave ekonomike apo materiale në raste të fatkeqësive natyrore, apo vështirësive të jetesës.

PAK - Persona me Aftësi të Kufizuar.

Ndihmë Ekonomike - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë me vështirësi ekonomike apo gjatë fatkeqësive natyrore.

TIK - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit.



Vlera totale e dhurimit të konstatuar në nivel vendi për vitin 2016 është 185,893,382 Lekë, ku përfshihen këto natyra dhurimi: **monetare, mallra/produkte dhe shërbime.**

Edhe këtë vit sikurse në vitin e kaluar, dhurimi monetar zë vendin e parë në natyrën e dhurimeve të kryera me 82% të vëllimit total, i ndjekur nga shërbimet me 12% dhe mallra / produkte me 6%.

Muaji gusht ka qenë muaji me vlerën më të lartë të dhurimit, 52,107,200 Lekë, ndërkohë që muaji maj zë vendin e parë për numrin e rasteve të dhurimit, me 57 raste të evidentuara.




⇒ 11,716,498 Lekë



⇒ 21,950,540 Lekë




⇒ 152,226,344 Lekë



Gjatë vitit 2016 janë konstatuar 279 raste dhurimi, nga të cilat 234 (84%) janë kryer në mallra / produkte, 36 (13%) në dhurime monetare dhe 9 (3%) në shërbime.


Vlera e Dhurimeve sipas Natyrës së Dhuruesve në Lekë



Përsa i përket vlerës së dhurimit, Individët zënë vendin e parë me një vlerë prej 108,322,236 Lekë, të ndjekur nga Biznesi me 30,069,360 Lekë, dhe OJF me 29,952,793 Lekë.

Në muajin nëntor, është regjistruar vlera më e lartë e dhurimit nga Individët prej 35,008,956 Lekë, ndërsa vlera më e ulët prej 2,100 Lekë është regjistruar në muajin maj, e kryer nga Institucionet Ndërkombëtare.


Numri i Dhuruesve*



Gjatë monitorimit janë evidentuar: 267 Individë, të cilët kanë dhuruar 71% të vlerës totale të dhurimeve, 67 Biznese që kanë dhuruar 18% të vlerës totale, dhe 21 Institucione Publike me 6% të vlerës totale.

*Për hatër të analizës dhuruesit llogariten vetëm një herë pavarësisht numrit të dhurimeve të kryera gjatë periudhës së monitoruar.

Shtirja Gjeografike e Dhuruesve




Qyteti i Tiranës është baza e dhuruesve për vitin 2016, me 76.4%, i ndjekur nga qyteti i Durrësit me 6%, Shkodra dhe Fieri me 5%.

Është vënë re një rritje e dhurimeve nga diaspora dhe nga shtetasit e huaj që i janë përgjigjur fushatave të ndryshme.

Për shembull, rasti i një grupi vullnetarësh të "Stichting Mar" Foundation, nga qyteti Leiden, Hollandë, të cilët nën kujdesin e Ambasadës Hollandeze iu bashkuan Fondacionit "Fundjavë Ndryshe" për të ndihmuar 15 familje që jetojnë në varfëri ekstreme në Tiranë dhe Durrës.

Një rast tjetër ishte shqiptari nga diaspora, Z. Fran Gjoka, që prej 24 vitesh jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili me rastin e festave të fundvitit dhuroi rreth 10 ton pako me ushqime për 150 familje në qytetin e Pukës.




90% e dhurimeve kanë shkuar për Ndihmën Ekonomike dhe lehtësimin e varfërisë, duke e bërë atë, fushën me dhurimin më të lartë për vitin 2016.

91% e rasteve të dhurimeve nga Individët, 78% nga Biznesi, 77% nga OJF, 96% nga Institucionet Publike, 87% nga Komunitetet Fetare dhe 100% të rasteve të dhurimeve nga Institucionet Ndërkombëtare dhe Subjektet Politike kanë shkuar për Ndihmën Ekonomike dhe zbutjen e varfërisë.


Ndërkohë është konstatuar një mungesë dhurimi për fushën e Mjedisit.

Përfituesit




Rastet më të shpeshta të dhurimeve për vitin 2016 kanë shkuar për Publikun e gjerë me 62.5%, ndjekur nga Fëmijët me 28%.

Shtrirja Gjeografike e Përfituesve




Edhe përsa i përket përfituesve, Tirana zë vendin e parë me 63.9% të dhurimeve, më pas vjen qyteti i Shkodrës me 8% dhe Durrësi me 6%.

Kanalet e Dhurimit



Kanalet kryesore të dhurimeve janë OJF me 113 raste (40.6%), Institucionet Publike me 106 raste (38%), ndërkohë që 55 raste (20%) kanë shkuar direkt tek Individ.





Media vazhdon të jetë mjete kryesor për promovimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe raportimin e dhurimeve të kryera. Gjatë vitit 2016 janë konstatuar 298 artikuj të publikuar në median sociale dhe të shkruar, ku media sociale ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm.

PSH ka konstatuar se dhjetori ka qënë muaji me numrin më të madh të publikimeve, me 85 artikuj, kjo për shkak të festave të fundvitit, një nga periudhat kur dhurohet më tepër. Më pas vjen muaji maj me 36 artikuj, muaji prill dhe qershor me 31 artikuj.

Mediat të cilat kanë publikuar numrin më të madh të artikujve mbi filantropinë apo rastet e dhurimit kanë qënë: Shqiptarja.com (24), Albeu.com (16), Top Channel (15), KohaJone.com (13), dhe Balkanweb (12).

- Facebook
- Shqiptarja.com
- Albeu.com
- Top Channel
- KohaJone.com
- Balkanweb
- Javanews.al
- Noa.al
- Panorama.com
- Oranews.tv
- Lajmifundit.al
- Sot News
- GazetaTema.net
- Shekulli.com
- Mapo.al
- Gazeta-Shqip.com
- ata.gov.al
- Gazeta Dita
- GazetaDita.com
- ABCnews
- OralInfo
- Rozafa TV
- StarPulusTv
- Syri.net
- Gazeta Tema
- Gazeta Standart
- Gazeta Koha Jone
- Gazeta Mapo
- Sporti Ekspres
- Gazeta Shqiptarja
- Gazeta Telegraf
- Supersport.al
- Gazeta55.al
- 24-ore.com
- Tv Klan
- VizionPlus.al
- Living.al

Dhurime nga Individë



Me dëshirën për të ndihmuar njerëzit në nevojë, disa nxënës të një shkolle 9-vjeçare në kryeqytet realizuan më 21 janar 2016, një shfaqje artistike me performanca të ndryshme nga tradita. Eventi u zhvillua në ditën ndërkombëtare të gjyshërve, për të treguar se kjo moshë nuk duhet harruar kurrë. Pjesëmarrja në shfaqje kushtonte simbolikisht 20 Lekë dhe me të ardhurat e grumbulluara, nxënësit blenë batanije dhe veshmbathje të nevojshme. Ata shkuan në Shtëpinë e të Moshuarve të Tiranës në emër të të gjithë grupit, për të dorëzuar ndihmat dhe për ata të moshuar që nuk mundën të ishin të pranishëm në shfaqjen e 21 janarit, nxënësit ofruan disa nga performancat artistike, duke u dhuruar atyre një ditë ndryshe.

Kur të rinjtë bëhen bashkë, asgjë nuk është e pamundur

Në 22 maj 2016, një grup prej pesë të rinjsh (Aldo Skënderi, Edian Meçe, Moris Backa, Rigels Hoxha dhe Hasan Zeneli) organizuan për të dytin vit rradhazi aktivitetin me titullin "Day N' Night – Kolonat N'Festë" i cili zgjati plot 12 orë, ku 13 DJ performuan falas dhe një pjesë e fitimeve nga ky event shkuan për fëmijët në nevojë. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte që nëpërmjet argëtimit, të rinjtë të sensibilizohen dhe të solidarizohen me kauzat që kërkojnë vëmendjen e të gjithëve.

"Day N' Night – Kolonat N'festë" për fëmijët në nevojë



Falë një donacioni me vlerë prej 50,000,000 Lekë nga prifti i Gurëzit Pasqule Nalli, nisi rikonstrukcioni i spitalit të qytetit të Laçit. Donacioni u përdor për ndërtimin nga e para e të gjithë sistemit hidrosanitar të spitalit dhe ndërtimin nga e para të 16 banjave. Falë këtij donacioni, spitali i qytetit të Laçit do të ofrojë kushte më të mira për qytetarët.

Rikonstrukcioni i Spitalit të Laçit

Një besimtar mysliman i dhuroi xhamisë së Tiranës një truall prej 1,400 metër katrorë me një vlerë prej 250,000 Euro për të ndërtuar një xhami në zonën e Paskuqanit, në Tiranë. Qytetari i bëri këtë dhuratë xhamisë pa kushte, në shërbim të besimtarëve.

Dhuratë për xhaminë e Tiranës

Dhurime nga Biznesi



Telekom Albania në shenjë solidariteti për momentet e vështira pas ngjarjeve tragjike në Belgjikë, ku pati shpërthime në aeroportin dhe metronë e qytetit të Brukselit, nisi më datë 24 mars të ofrojë thirrje falas drejt të gjithë numrave fiks dhe celular të këtij shteti. Kjo iniciativë zgjati deri në fund të muajit mars për t'i lehtësuar komunikimin shtetasve shqiptarë me të afërmit dhe miqtë që jetojnë në Belgjikë.

Telekom Albania ofron komunikim falas me Belgjikën

Gjatë tetorit, muajit për rritjen e ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, Alpha Bank Albania nisi fushatën ndërgjegjësuere "Jemi të gjithë luftëtarë kundër kancerit të gjirit", duke u bërë thirrje të gjithë kartëmbajtësve të mbështesnin këtë fushatë, nëpërmjet përdorimit të kartave të kreditit të lëshuara nga Alpha Bank Albania. Pas grumbullimit të të ardhurave të gjeneruara nga përdorimi i kartave të kreditit dhe në kuadër të përgjegjësisë sociale dhe angazhimit publik, Alpha Bank Albania zgjodhi të dhurojë 25,000 Euro, për blerjen e një aparati ekografie për Spitalin Onkologjik në Tiranë, e cila do të përdoret për kryerjen e diagnozave në kohën e duhur të sëmundjeve të ndryshme kancerogjene.

Jemi të gjithë luftëtarë kundër kancerit të gjirit



Vodafone Albania nëpërmjet Fondacionit Vodafone Albania ka realizuar ëndrrën e fëmijëve në Theth, duke bërë të mundur që brenda një muaji ata të kishin një shkollë të rinovuar plotësisht. Shkolla e Thethit është ndërtuar në vitet 80'-të dhe e lenë në kushte të dëshpëruara pa energji elektrike, pa furnizim me ujë, dritare me xhama të thyer, pa mobilje dhe pajisje, dhe pa WC. Me rikonstrukcionin e shkollës brenda pak javëve, fëmijët e Thethit gëzojnë tani një shkollë në kushte shumë të mira, të pajisur plotësisht me mobilje, sistem ngrohje, furnizim me ujë në ndërtesë, si dhe materiale didaktike dhe arsimore.

Thethi me një shkollë të re

Mamografi falas për gratë e burgosura

Në nderim të kujtimit dhe veprës së drejtorit të spitalit Hygeia, Andreas Vgenopoulos, i cili ndërroi jetë në nëntor 2016, Bordi i këtij spitali dhuroi 3,000 Euro për Fondacionin "Down Syndrome Albania". Organizatën në mbështetje të bebeve të braktisura – Programi Djepi i Engjëjve, dhe Shtëpinë e Fëmijës "Zyber Hallulli". Gjithashtu, spitali Hygeia gjatë kësaj periudhe ofroi Mamografi falas për gratë që vuajnë dënimin në burgun e Ali Demit.

Dhurime nga OJF-të





Mjete mësimore dhe veshje për fëmijët jetimë

Në prag të nisjes së vitit të ri arsimor, shoqata e Katarit në Shqipëri dhuroi 122,000 Euro për mjete mësimore dhe veshje për 950 fëmijë jetimë nga e gjithë Shqipëria.

Klubi i Tiranës i "rikthen" këmbën të moshuarit

Falë ndihmës financiare të Klubit të Futbollit të Tiranës, Mezini, një i moshuar me aftësi të kufizuara mund të ecë sërish. Bardheblutë i ofruan mundësinë e një trajtimi mjekësor dhe vendosjen e një proteze. Tanimë ai mund të lërë mënjanë patericat dhe të ecë normalisht.



Dhurime nga Institucionet Publike



Festat duan dashuri

"Festat duan dashuri", është aktiviteti kombëtar që Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMRS) organizoi gjatë festave të fundvitit, ku në çdo qendër të përkujdesjes, në 28 të tilla në të gjithë vendin, u organizuan festa dhe u shpërndanë dhuratat. Kryeministri dhe çdo anëtar i kabinetit qeveritar ishte pranë një qendre për të kaluar orë festive dhe shprehur solidaritetin e dhënë mesazhin e përkujdesjes ndaj njerëzve që kanë më shumë nevojë. Thirrjes së MMSR iu bashkuan gjithashtu organizata jo-qeveritare dhe mediat kryesore në vend.



Dhurime nga Komunitetet Fetare



Ndihma ekonomike për familjet e përmbytura në Shkup

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë akordoi 20,000 USD ndihma ekonomike për familjet e përmbytura gjatë muajit gusht në Shkup, ku dhjetra persona humbën jetën, në mesin e të cilëve edhe shqiptarë.

Dhurime nga Institucionet Ndërkombëtare & Subjektet Politike



Dhurata për Qendrat e përkujdesjes në Tiranë

Gjatë muajit janar Lëvizja Socialiste për Integrim në Shkodër dhuroi lodra, tavolina dhe karrige për Shtëpinë e Fëmijëve Parashkollorë në Shkodër.

Gjithashtu, UN Women Albania dhuroi pajisje kompjuterike për Qendrat Polivalentë në Tiranë dhe Kamëz.

Edhe pse vlera e dhurimit për vitin 2015 ka qenë më e madhe, numri i rasteve të dhurimit gjatë 2016 është rritur me 29%. Monitorimi ka treguar se është rritur numri i fushatave ndërgjegjësuese & bamirëse dhe eventeve për ngritje fondesh për kauza të ndryshme sociale.

“Përqafo Ndryshimin, Mbështet Përparimin”, Gala Bamirësie

Në 20 maj 2016, u zhvillua për të dytin vit rradhazi nata gala në mbështetje të Strehës për Personat LGBT në Shqipëri, ku morën pjesë persona të njohur nga fusha e medias, biznesit, politikës, artit dhe përfaqësues nga fondacione e organizata të shoqërisë civile. Të gjitha të ardhurat e grumbulluara nga mbrëmja gala shkuan për të siguruar vazhdimësinë e akomodimit, ushqimin dhe mbështetjen psiko-sociale për të rinjtë LGBT që janë viktimë të abuzimit dhe diskriminimit.

27 Me Dritë

27 Me Dritë, ishte event i bamirës që Agnesa Hadërgjonaj, Ketrina Jarazi, Elvis Ponari dhe Fatjola Lubonja, me mbështetjen e një numri të madh biznesesh në vend, organizuan më datë 27 dhjetor 2016, për t’u ardhur në ndihmë familjeve në nevojë. Të ardhurat që u mbledhën nga kjo iniciativë shkuan për: mjekimin në Turqi të tre fëmijëve të diagnostikuar me kancer, pajisje elektrike dhe ushqime për gjashtë muaj, për pesë familje në nevojë. Dy prej këtyre familjeve iu mundësua rikonstruksioni i shtëpive, pasi ishin në gjendje të mjerueshme. Gjithashtu, nëpërmjet këtij event i u siguruan artikuj shkollorë për 30 fëmijë të komunitetit rom.

Okaidi Love Bag

Fëmijë nga 200 familje në nevojë, morën pjesë në festën e organizuar për ta nga Okaidi, në ambjentet e Teatrit Kombëtar Eksperimental, si pjesë e fushatës së kësaj marke për dhurimin e çantave të dashurisë “LOVE BAG”. Përveç çantave të mbushura me rroba dhe mjete të nevojshme, fëmijet morën edhe dhurata festive si dhe shijuan një shfaqje teatrale të dedikuar për ta, mundësuar nga Teatri Kombëtar Eksperimental. Kjo datë u zgjodh posaçërisht pasi përkoj me çeljen e sezonit festiv dhe ditën e Shën Nikollës, shenjt i dhuratave.

Babagjyshi Sekret


Në fundvitin e 2016, organizata “Ura” dhe kompania “Connex” ideuan një nismë për t’i dhuruar fëmijëve dhuratat që ata dëshirojnë nga Babagjyshi. Nisma u quajt “Babagjyshi Sekret” dhe kishte për qëllim të sjellë sa më shumë buzeqeshje tek fëmijët në mbarë Shqipërinë. Nisma “Babagjyshi Sekret” filloi pranimin e letrave nga fëmijet prej datës 6 dhjetor dhe vazhdoi deri në datën 25 dhjetor, dhe shumë fëmijë morën dhuratën e dëshiruar.

“Shqipëria uron, Shqipëria dhuron”

Viti 2016 është viti i tretë që Kryeministria riktheu nismën “Shqipëria uron, Shqipëria dhuron” gjatë festave të fundvitit. Kryeministria njoftoi se prej orës 18.30 të datës 24 dhjetor 2016, të gjithë do të kishin mundësinë për të shkruar urimet në murin e kryeministrisë. Nga data 24 dhjetor deri më 2 janar të gjithë kishin mundësinë të ndanin gëzimin e festave me kë dëshironin përmes një mesazhi, imazhi apo video që u projektua mbi murin e Kryeministrisë. Të gjithë të ardhurat e mbledhura nga postimi i sms-ve, fotove apo videove të urimit shkuan për bamirësi.

Krahasimi mes
2015 - 2016


Vlera Totale e Dhurimeve & Numri Total i Dhurimeve




Vlera totale e dhurimit për vitin 2016 është ulur me 52% në krahasim me vitin 2015, ndërkohë që numri i dhuruesve është rritur me 29%.

Për vitin 2016 dhuruesit kryesorë kanë qenë Individët (267), ndryshe nga viti 2015 ku numri më i madh i dhuruesve ishin Biznese (72).


Numri i Dhuruesve



Kanalet e Dhurimit




Fushat e Dhurimit



Kanalet kryesore të dhurimeve për vitin 2016 kanë qenë OJF, ndërkohë që për vitin 2015 dhurimet janë kanalizuar më së shumti nëpërmjet Institucioneve Publike.

Përfituesit



Sikurse vihet re edhe nga grafikët mbi Fushat e Dhurimit dhe Përfituesit, e përbashkëta për të dy vitet janë vlerat më të larta të dhurimeve në fushën e Ndihmës Ekonomike, dhe Publiku i gjerë si përfitues kryesor.



Rruga Sulejman Delvina, N.18, H.8, Ap. 12, Njësia Bashkiake 5,
Kodi Postar 1022, Tiranë, Shqipëri,
Kutia Postare (PO Box) 2418/1
Tel./Fax 04 2254881
Email: partners@partnersalbania.org
<http://www.partnersalbania.org>